

UDHËZIME PËR BALANCËN GJINORE

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME PËR NJERËZIT E TË GJITHA GJINIVE TË STUDIOJNË DHE PUNOJNË NË FUSHAT STEM?

Vitet e ardhshme, me zhvillimin e ekonomisë së Evropës dhe rritjen e teknologjive të reja, aftësitë në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë (STEM) po bëhen gjithnjë e më shumë të nevojshme për të garantuar një krah pune të përshtatshëm profesional në një gamë të gjerë karrierash. Prandaj, është e domosdoshme të tërheqim dhe të rekrutojmë më shumë të rinj në programet e studimit STEM dhe të sigurojmë diversitetin e profesionistëve të mësuara. *The Vision of Hypatia* është shoqëri evropiane që merret me komunikimin e shkencës për të rinjtë, në një mënyrë gjithëpërfshirëse gjinore, me qëllim që të realizojë potencialin e plotë të vajzave dhe djemve në mbarë Evropën për të ndjekur karrierë në fushat e lidhura me STEM-in.

Institucionet dhe lehtësuesit përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të edukimit shkencor, si shkollat, muzetë dhe industrinë, luajnë rol kyç në këtë drejtim. Ato mund të ushtrojnë ndikim mbi mënyrat në të cilat nxënësit i ndërtojnë dhe negociojnë gjinitë e tyre dhe qëndrimin e tyre ndaj STEM. Prandaj, është e rëndësishme të reflektojmë mbi parimet që kemi për gjininë dhe shkencën, të pranojmë stereotipet dhe të sigurohemi që nuk i shfaqim ato në ndërveprimet me pjesëmarrësit.

LHETËSIMI I PËRFSHIRJES GJINORE

Ndërkohë që lehtësohen aktivitetet gjithëpërfshirëse gjinore, është e rëndësishme të jemi të ndërgjegjshëm për disa koncepte të rëndësishme.

GJINIA DHE SEKSI

Seksi i referohet karakteristikave dhe funksioneve biologjike të cilat janë dalluese ndërmjet meshkujve dhe femrave: seksi kromozomal, seksi gonadal, seksi morfologjik.

Gjinia i referohet ndërtimit social të burrave dhe grave, maskulinitetit dhe feminitetit, që ndryshon në kohë dhe hapësirë, dhe nga njëra culture në tjetrën. Gjinia është sistem hierarkik dhe hierarkizues i normave mashkullore dhe femërore.

STEREOTIPET DHE AFTËSITË GJINORE

Stereotipi gjinor është perceptimi ynë shoqëror në lidhje me atributet e meshkujve dhe femrave (karakterit, aftësitë, prirjet, preferencat, pamja e jashtme, llojet e sjelljes, rolet, shtigjet e karrierës etj.) dhe tendenca jonë për t'i lidhur këto attribute të individëve të secilës gjini, para se t'i takojmë ata personalisht (shembulli i stereotipit: meshkujt janë më racionalë dhe femrat më emocionale).

Kur flasim për stereotipet gjinore dhe shkencën, ne i referohemi roleve dhe aftësive që supozohet të jenë "të përshtatshme" për meshkujt dhe për femrat në shkencë (për shembull, inxhinieria dhe ndërtimi lidhen më shumë me meshkujt sesa me femrat).

GJINIA DHE SHKENCA

Fushat STEM janë fusha të kërkimit dhe njohurive. Ashtu si format e tjera të dijes, ato mund të përfshijnë përmasa gjinore. Kur nuk merret parasysh variabli gjinor nga kërkuesit, kjo mund të ushtrojë ndikim mbi rezultatet: për shembull kur medikamentet nuk testohen njësoj si për meshkujt, edhe për femrat. Për më tepër, ekziston një hendek i vazhdueshëm gjinor në sistemin e prodhimit të njohurive shkencore dhe teknologjike dhe në shumë vende evropiane gratë janë të mbipërfaqësuar në biologji dhe shkenca mjekësore, ndërsa janë të nënpërfaqësuar në matematikë, ose në

informatikë.

Përveç kësaj, gratë kanë më pak gjasa të arrijnë një nivel të lartë përgjegjësie në fushën e shkencave.

Ato përshkruhen si racionale, intelektuale dhe të pavarura, dhe këto karakteristika shpesh shoqërohen me maskulinitetin.

Kjo do të thotë se djemtë ose vajzat që nuk identifikohen me karakteristika të tilla mund të mendojnë se studimet dhe profesionet STEM nuk janë "për ta" dhe t'i shmangin ato plotësisht. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të paraqesim një imazh kompleks dhe të larmishëm të shkencës.

SUGJERIME PER ZBATIMIN E AKTIVITETIT

Përcaktimi, njohja dhe zbatimi i aktiviteteve gjinore përfshirëse është punë komplekse dhe sfiduese dhe kërkon refleksion të vazhdueshëm nga ana e lehtësuesit rreth stereotipit dhe anshmërisë së tij gjinore. Më poshtë jepen disa tregues praktikë dhe pyetje reflektimi për t'i ndihmuar lehtësuesit për të qenë sa më përfshirës të jetë e mundur.

NDËRVEPRIMI ME GRUPIN

- **Neutraliteti në caktimin e detyrave dhe roleve**

Si do t'i caktoj detyrat? Cilat përgjegjësi do t'i caktoj kujt?

Shmangni caktimin e roleve stereotipike gjinore për pjesëmarrësit që mund të kontribuojnë në internalizimin e identiteteve "femërore" ose "maskullore", për shembull duke u kërkuar djemve të ndërtojnë gjëra dhe vajzave të mbajnë shënime. Sigurohuni që pjesëmarrësit të ndërrojnë rolet e ndryshme që kërkojnë në kuadër të aktivitetit.

- **Atribuimi i suksesit dhe dështimit, duke tejkaluar përgjigjet stereotipike**

A e lidhin nxënësit meshkuj dështimin me veten apo me faktorët e jashtëm?

Po nxënëset femra që kanë që ia kanë dalë, a e lidhin suksesin e tyre me veten, apo me faktorët e jashtëm?

Vendosni një nivel të lartë pritshmërisë për të dyja gjinitë.

Shmangni vëmendjen e tepërt mbi vajzat (kjo çon në varësi dhe jo në pavarësi). Inkurajojini si vajzat edhe djemtë që të marrin përsipër rreziqe.

- **Përqafoni qasjen e "kohës së pritjes" për t'i inkurajuar vajzat të flasin në një mjedis djemsh që ndërmarrin rreziqe dhe që mund të reagojnë më shpejt se sa ato.**

Sa i kujdesshëm isha ndaj përgjigjeve të nxënësve? Sa kohë u lashë atyre të flasin?

Pritni për 4–5 sekonda përpara se t'i kërkonit një nxënësi që t'i përgjigjet një pyetjeje. Vonesa e përgjigjes u mundëson të gjithë nxënësve të përgjigjen, duke i dhënë kështu të gjithëve mundësinë për të dhënë përgjigjen e pyetjes.

- **Ndërveprimi me gjinitë për të kapërcyer tendencën e përfshirjes së nxënësve meshkuj më shumë se sa të nxënësve femra:**

A u drejtova më shumë pyetje djemve sesa vajzave?

Jini të vetëdijshëm nëse pyetjet u drejtohen më shumë djemve, apo vajzave.

- **Shprehja e pandërgjegjshme e stereotipeve**

A i kushtova vëmendje sjelljes së nxënësve në lidhje me shprehjen e stereotipeve gjinore prej tyre?

Adoleshentët shpesh i riprodhojnë stereotipet gjinorë në mënyrë të pandërgjegjshme, ose në mënyrë delikate. Kjo mund të merret si mundësi për ta nënvizuar dhe për ta përdorur këtë qasje si pikë reflektimi.

GJATË DISKUTIMIT

• *A janë djemtë më të interesuar në ndërtimin e gjërave dhe vajzat në dekorimin e gjërave të prodhuara? A mund t'i ndryshoni këto role në aktivitete?*

Sfidojini nxënësit të largohen nga interesat e preferuara dhe të zgjerojnë angazhimin në shkencë (shumë fëmijë kanë interesa stereotipike gjinore që mund të sfidohen).

• *A mendoni se mund të jetë me dobi që të prezantoni dhe diskutoni konceptin e gjinisë, ose stereotipeve para ose pas aktivitetit?*

Analizoni nëse shpjegimi paraprak i koncepteve kryesore rreth gjinisë dhe rreth terminologjisë/konceptit përkatës mund ta pasurojë diskutimin.

• Ndërsa lehtësoni diskutimin

Pranoni se nxënës të ndryshëm kanë lloje të ndryshme njohurish paraprake, të cilat mund të jenë të rëndësishme në mënyra të ndryshme. Diskutimi mund të niset me atë nxënësit dinë për temën.

TË TAKOHESH ME NJË PROFESIONIST STEM

Modelet janë efektive për nxitjen e interesit të vajzave dhe djemve në STEM. Shumë aktivitete kanë si protagonistë profesionistët e fushave STEM, ose japin shembuj të profesionistëve STEM. Është e rëndësishme që këto modele të mos përforcojnë stereotipet gjinorë.

• *Sa burra dhe sa gra shfaqen në shembullin e profesionistëve të fushave STEM që jap në aktivitet? A janë ato stereotipike?*

Mbani një ekuilibër mes numrit të femrave dhe meshkujve si folës, ose si shembuj. Kur është e mundur, kërkon nga ata që e marrin fjalën që flasin jo vetëm për përmbajtjen shkencore, por edhe për jetën e tyre personale.

Sigurohuni që mësuesit dhe shkencëtarët e përfshirë në

shkencë të reflektojnë një shumëllojshmëri të gjerë personalitetesh. Vajzat dhe djemtë janë më të frymëzuar nga modelet me të cilët ndihen psikologjikisht të ngjashëm me veten (sa i përket origjinës, kulturës, moshës, etj.). Përndryshe, standardet e përcaktuara nga personi tjetër mund të shihen si kontradiktore dhe vajzat dhe djemtë mund të reagojnë kundër tyre.

• *Në aktivitete, a paraqes lloje të ndryshme të STEM-it – nga lojërat kompjuterike deri tek inxhinieria?*
Ndërsa zgjidhni profesionistët e fushave STEM dhe shembuj të përfshirë në aktivitete, sigurohuni që diversiteti i shkencës të përfaqësohet në masën më të madhe të mundshme.

LEHTËSIMI I NJË SITUATE EKSPERIMENTALE

Ndërsa merren me një përmbajtje specifike shkencore, pjesëmarrësit mund të mos shohin qartë se si kjo përmbajtje lidhet me balancën gjinore në fushat STEM. Aktivitetet e *Hypatia*-s synojnë të propozojnë mënyra të papritura për t'iu qasur shkencës dhe përmbajtjes shkencore (si kimia, robotika, apo ndërtimi), duke thyer perceptimin stereotipik të fushave STEM. Kjo shërben për të prezantuar dhe përhapur një këndvështrim tjetër të botës së shkencës, duke zbuluar aspekte të ndryshme me të cilat mund të identifikohen më shumë njerëz, si vajza edhe djem. Mund ta theksoni këtë aspekt ndërsa lehtësoni një aktivitet të përqendruar në përmbajtjen shkencore, jo në gjini.

- Për shembull, teknologjia për kornizimin e aktiviteteve, si teknologjitë e aparaturave që mund të mbahen me vete, mund të tërheqë më shumë vajzat sesa teknologjia e transportit, ose e raketave.
- Shumë vajza ndihen më rehat në situatat e bazuara në bashkëpunim, madje ka vajza që i shmangin fare aktivitetet konkurruese. Lehtësuesi mund të paraqesë një sfidë duke pasur një "histori" pas saj, dhe të mos bëjë vetëm një konkurs, ose t'i kushtojë vëmendje balancimit të njëjtë të konkurrencës dhe bashkëpunimit.
- Shumë studime tregojnë se vajzat mësojnë më mirë në një mjedis që është estetikisht i këndshëm. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të krijohet një mjedis i këndshëm dhe estetik për aktivitetet.

LIDHJE TË DOBISHME MBI PËRFSHIRJEN GJINORE NË KLASË

KORNIZA TEORIKE E HYPATIA-S

Ky dokument propozon një kuadër për të trajtuar përfshirjen gjinore në aktivitetet e fushave STEM. Ai çon në një sërë kriteresh për analizën e përfshirjes gjinore në aktivitetet ekzistuese të edukimit në fushat STEM, ose për hartimin e aktiviteteve të reja, përfshirëse gjinore.

[Korniza teorike](#)

BARAZIA GJINORE NË KLASË

Shpesh nuk jemi të vetëdijshëm për mënyrën se si raportohemi me djemtë dhe vajzat. As klasat e shkollave nuk bëjnë përjashtime në këtë drejtim. Më poshtë jepet një listë e pikave për t'u pasur parasysh dhe sugjerimeve që kanë për qëllim përmirësimin e nivelit të barazisë në klasë, me qëllim inkurajimin e vajzave dhe djemve që të ndjekin fushat e STEM.

[Barazia gjinore ne klase](#)

UDHËZIME PËR LEHTËSIMIN

CA KËSHILLA SI TË JEMI LEHTËSUES TË MIRË

Një element kyç për lehtësim të mirë është përfshirja aktive e pjesëmarrësve sa herë që paraqitet një concept, apo përmbajtje. Përfshirja do të thotë, për shembull:

- T'i pyesësh pjesëmarrësit për përvojën personale si pikë fillestare angazhimi.
- Të mbështetesh në pikëpamjet ose njohuritë paraprake të tyre.
- Të përfshish në mënyrë të vazhdueshme kontributet e pjesëmarrësve në proces.

Lehtësimi nuk është i lehtë. Ai kërkon praktikim, kohë dhe reflektim! Për t'i transferuar këto koncepte në situata praktike dhe, në këtë mënyrë, për të nxitur angazhimin, ndërveprimin dhe diskutimin, mund të gjeni një listë të shkurtër të sugjerimeve më poshtë.

Këto sugjerime mund t'ju ndihmojnë për ta realizuar më mirë lehtësimin.

NDËRVEPRIMI ME GRUPIN

- Përgatiteni paraprakisht mjedisin ku do të zhvillohet aktiviteti, organizoni hapësirën sipas nevojave të aktivitetet që do të zhvillohen, madje edhe duke ndryshuar strukturën e zakonshme të tij, nëse është e nevojshme (p.sh. mund të lëvizni tavolinat dhe karriget për të krijuar mjedis të përshtatshëm pune).
- Sigurohuni që të gjithë pjesëmarrësit të mund të shohin dhe të dëgjojnë mirë.
- Ruani kontaktin me sy me pjesëmarrësit.
- Drejtojuni pjesëmarrësve si bashkëmoshatarë, më tepër sesa si spektatorë pasivë ose individë që nuk marrin vesh.

- Dëgjojini njerëzit dhe përdorni termat e tyre.
- Përdorni sa më shumë pyetje të jetë e mundur. Ato mund të jenë mjet i dobishëm për të nxitur ndërveprimin në grup.
- Nxitni reflektimet midis pjesëmarrësve.
- Nëse është e mundur, bëni pyetje dhe mbështetuni në informacion ose elementë që mund të zbulohen përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë.
- Angazhojini njerëzit duke u lidhur me përvojën e tyre personale.
- Inkurajojini pjesëmarrësit të shprehin mendimin e tyre dhe të përpunojnë mendimet e tyre.
- Gjatë një aktiviteti, mund të dëshironi të organizoni ambiente të ndryshme grupi, të punoni në grupe të vogla, ose në grupe prej dy vetësh, të mblidhni të gjithë klasën në një seancë diskutimesh, për të ndihmuar për sigurimin e një angazhimi më të madh dhe ndërveprimin më të mirë me përvojën.
- Para se të bashkëveproheni me pjesëmarrësit në seancë plenare, mund të dëshironi t'u kërkonit pjesëmarrësve të diskutojnë në grupe të vogla sa për "nxehje". Kjo ndihmon në përfshirjen edhe të njerëzve më të turpshëm, ose i ndihmon të gjithë të ndihen më rehat mbi temën para diskutimit si klasë.
- Kur diskutimi bëhet në grupe të vogla, lëvizni përreth grupeve që kontrollojnë punën dhe diskutimin dhe ndërhyri
- – vetëm në rast vështirësish!
- Në seancë plenare, përpiquni t'u drejtoheni të gjithëve sa më shumë që të jetë e mundur, duke i inkurajuar të gjithë që të marrin pjesë dhe të angazhohen.

KUR LEHTËSONI NJË SITUATË EKSPERIMENTALE

- Përpiquni ta bëni aktivitetin sa më pjesëmarrës: çdo

pjesëmarrës duhet të ketë mundësinë të angazhohet drejtpërdrejt me eksperimentin; shmangni demonstrimet.

- Mos zbuloni rezultatet e përvojës para se të dëgjoni zbulimet dhe mendimet e pjesëmarrësve.
- Inkurajojini pjesëmarrësit të bëjnë hipoteza fillestare/përshkrime/komente lidhur me atë që ata mendojnë se do të ndodhë.
- Mbajeni eksperimentin në qendër të vëmendjes dhe të diskutimit.
- Angazhoni nxënësit përmes alternativit të aktiviteteve manuale, pyetjeve dhe diskutimeve.

GJATË DISKUTIMIT

- Angazhoni nxënësit përmes një ekuilibri midis pyetjeve të hapura, pyetjeve të mbyllura, diskutimit dhe shkëmbimit të mendimeve, etj.
- Mund ta gjykoni me vend të përdorni dilema provokuese si mjete për debat. Mosmarrëveshjet mund të jenë të vlefshme për analizimin e nocioneve dhe për të diskutuar mbi pikëpamjet, kështu që përdorini ato në mënyrë konstruktive.
- Nxitni dhe bazohuni jo vetëm në njohuritë tashmë të fituara të pjesëmarrësve, por edhe në emocionet dhe imagjinatën e tyre.
- Sfidojini pjesëmarrësit në një nivel të përshtatshëm.
- Shmangni:
 - qasjen didaktike dhe vlerësimin e njohurive të pjesëmarrësve;
 - monologjet;
 - termat e specializuara pa iu referuar objekteve reale.
 - kërkimin e saktë, ose marrjen vetëm me përgjigjet e sakta ose, edhe më keq akoma, me pyetjet e sakta.
 - mosdëgjimin

FTIMI I NJË PROFESIONISTI TË FUSHAVE STEM

- Mund t'i sugjeroni folësit që të bëjë alternativë të pyetjeve dhe prezantimit, për t'u lejuar pjesëmarrësve të ndërmarrin një rol më aktiv dhe për të parandaluar bisedimet e gjata.
- Para prezantimit të një profesionisti të fushave STEM, mund t'u kërkoni pjesëmarrësve të ndajnë perceptimin e tyre rreth profesionit të caktuar dhe pastaj ta diskutojnë mbi to me folësin.
- Pjesëmarrësit e rinj, kur kanë mundësinë të bëjnë pyetje të hapura, shpesh duket se janë të interesuar në jetën e përditshme personale të folësit, në rrugën e tyre të karrierës, dhe se si kanë qenë ata kur kanë qenë të rinj. Mund t'i sugjeroni folësit që t'i përdorë këto tema si "gropa" gjatë prezantimit dhe bisedave.

Do të ishte mirë që folësit të sillnin mjete ose objekte nga puna e tyre e përditshme për t'i përdorur si shembuj ilustrues të praktikës së tyre të përditshme.

PYETJET: INSTRUMENT BAZË PËR PROCESIN E TË NXËNIT

Ndërtimi i një marrëdhënieje me një objekt është si të "njohësh një person të ri". Në të vërtetë, ky lloj krahasimi mund të ndihmojë për të kuptuar një mënyrë të mundshme për zhvillimin e pyetjeve që do të përdoren në përvojat e të nxënit. Në procesin e njohjes së një personi, ose fillimin e një bisede me të, ne lëvizim nga informacioni bazë dhe konkret, tek informacioni abstrakt dhe më kompleks. Përdorimi i pyetjeve në një situatë të të nxëni përfshin të njëjtët hapa: duke filluar nga informacioni bazë (zakonisht elementë që mund të zbulohen përmes vëzhgimit), dhe duke punuar në nivele ku ka pajtueshmëri (p.sh. nivelet ku

nxënësit mund të përfshihen dhe angazhohen përmes njohurive, përvojave dhe pikëpamjeve të tyre), në mënyrë që të vazhdohet më tej me zbulimin e informacionit dhe koncepteve më komplekse. Një qasje e tillë i fton nxënësit të kërkojnë brenda repertorit të tyre të njohurive dhe përvojës elementët e nevojshëm që do t'i ndihmonin ata për të zbuluar informacione të reja, ndërsa në të njëjtën kohë mund të funksionojë edhe si bazë për zhvillimin e pyetjeve nga vetë nxënësit.

Në fakt, ne nuk po diskutojmë këtu për një proces linear të "lehtësuesit që pyet – dhe nxënësit që përgjigje"; përkundrazi, po argumentojmë një proces kontributi të dykahshëm, ku si lehtësuesi edhe nxënësi janë në pozicionin e bërjes së pyetjeve ndaj njëri-tjetrit. Në këtë kuptim, pyetjet janë stimuli për nisjen e dialogut, pra janë instrumente, jo objektiva. Ato lejojnë nxjerrjen e njohurive të reja dhe shtimin e ideve brenda rrjedhave të lira të ideve, duke çuar në zgjerimin e të kuptuarit.

Cilat janë llojet e pyetjeve që mund të përdoren si metoda për nxjerrjen e informacionit dhe interpretimin, për fillimin e dialogut konstruktiv, për zhvillimin e aftësive dhe vetëbesimit tek nxënësit dhe lehtësuesit?

Para së gjithash, kategoritë bazë janë:

- Pyetjet e mbyllura – pyetjet që kanë vetëm një përgjigje të saktë.
- Pyetje e hapura – pyetjet që pranojnë më shumë se një përgjigje të saktë.

Pyetjet e mbyllura zakonisht përdoren kur kërkojmë informacione specifike rreth fenomenit/temës/provës/objektit, etj. dhe mund të ndahet më tej në:

- Pyetje për shqyrtim: përgjigjja e këtyre pyetjeve kërkon ekzaminim të kujdesshëm. Përgjigjet ofrojnë informacionin e parë në bazë të së cilit ndërtojmë njohuri më të hollësishme.
- Pyetje për shpjegim: përgjigjet ofrojnë një shpjegim – se si funksionon diçka, se si është krijuar diçka, etj. dhe janë të lidhura ngushtë me informacionin që rrjedh nga pyetjet për shqyrtim.
- Pyetje për krahasim: këto lloj pyetjesh stimulojnë krahasime me situata të tjera të të njëjtit lloj, material, përmasa etj. dhe inkurajojnë identifikimin e ngjashmërive, dallimeve dhe lidhjeve me njohuritë dhe përvojën personale të nxënësve.

Nga ana tjetër, pyetjet e hapura inkurajojnë shprehjen e pikëpamjeve personale, përdorimin e njohurive ekzistuese të nxënësve dhe kërkime domethënëse me vlerë personale. Diskutimet dhe pyetjet e hapura u ofrojnë nxënësve mundësinë për të bashkuar idetë dhe për të shkëmbyer njohuri në grup, dhe pasohen nga mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të kuptimeve përmes përdorimit dhe mbrojtjes së mendimeve dhe opinionëve.

Pyetjet e hapura mund të ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Pyetje për zgjidhjen e problemeve: Ato kërkojnë përdorimin e të menduarit kritik, të menduarit imagjinar, hipotezave dhe aftësive analitike, dhe aftësinë për përdorimin e njohurive për zgjidhjen e problemeve.
- Pyetje për parashikim: Përgjigjet për këto pyetje ofrojnë parashikime për rastet e ndryshimeve të parametrave.
- Pyetjet për gjykime: Përgjigjet për këto pyetje mund të jenë shumë personale dhe unike. Ata kërkojnë zgjedhje, vlerësim të situatës, justifikim, etj.

Duhet të kërkonim të gjeni një ekuilibër mes pyetjeve të mbyllura dhe pyetjeve të hapura. Përdorimi i vetëm pyetjeve të mbyllura mund të krijojë një ndjenjë padijeje midis nxënësve që e kanë të vështirë t'u përgjigjen këtyre llojeve pyetjeve, pasi ato kërkojnë përdorim relativisht të vogël të aftësive dhe më shumë njohuri të specializuara. Pyetjet e mbyllura duhet të përdoren për të eksploruar objektin dhe njohuritë e reja rreth tij, dhe përveç kësaj, ofrojnë bazën mbi të cilën duhet të bëhen pyetjet e hapura. Për çdo nxënës, përgjigjja e pyetjeve të hapura nënkupton përdorimin e kontekstit personal për të gjetur informacion të ri. Kjo u bën po ashtu të mundur të përdorin përvojat, emocionet, imagjinatën dhe aftësitë vetjake për të nxjerrë kuptim dhe për të bërë interpretime personale.

Në filozofinë e një qasjeje interaktive dhe konstruktive ndaj të nxënësve, bërja e pyetjeve dhe përgjigjja e pyetjeve nënkupton jo vetëm pranimin e më shumë se një përgjigje të saktë (përmes pyetjeve të hapura), por edhe "lejimin e gabimeve nga nxënësit", domethënë duke mos lejuar që situata e të nxënësve të kufizohet vetëm tek kërkimi i përgjigjeve "korrekte", ose marrja e rezultateve të paracaktuara. Është e rëndësishme që moderatorit të mos kërcejë shumë shpejt për ta korigjuar nxënësit, por të përdorë konfliktet që lindin midis perspektivave të ndryshme të nxënësve, duke i ndihmuar ata që të shohin se ka standard, dhe se interpretimet e tyre nuk janë domosdoshmërisht të njëjta ose më të mira sa interpretimet e dhëna nga nxënësit e tjerë. Duhet të inkurajohen rezultatet e të mësuarit nga referimi i situatave dhe mundësive për eksplorim përmes gjykimit dhe gabimit, dhe të mbështurrit në to.

Hypatia PROJECT

Hypatia është projekt i financuar nga *EU Horizon 2020* dhe trajton sfidën e kontributit të aktorëve të ndryshëm shoqërorë për të siguruar më shumë adoleshentë, sidomos vajza, për karrierë në fushat STEM, si në shkollë, ashtu edhe si përzgjedhje për të mësuarit dhe karrierën në të ardhmen. Ai synon të ndryshojë mënyrën se si shkencat u komunikohen të rinjve brenda dhe jashtë shkollës për t'i bërë ato më përfshirëse në aspektin gjinor.

Ky projekt ka marrë fonde nga Programi Kuadër *Horizon 2020* i Bashkimit Evropian për Kërkimet dhe Novacionin (H2020-GERI-2014-1), nën marrëveshjen e grantit Nr. 665566.



Aktiviteti është prodhuar nga Muzeu Kombëtar i Shkencës dhe Teknologjisë *Leonardo da Vinci*, Milano, si pjesë e projektit *Hypatia* të financuar nga në kuadër të *Horizon 2020*.

Aspekti gjinor i Kërkimit dhe Novacionit të Përgjegjshëm (RRI) është shumë i fortë.